

| | |
|--|-----------|
|  REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT / MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA AGJENCIA SHTETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS / DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES | |
| Nr./Br./No. | 01122/21 |
| Data/Datum/Date: | 19.1.2021 |



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT/MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I

SPORTA/MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS

AGJENCIA SHTETËRORE E ARKIVAVE E KOSOVËS/DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA/

STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES

Në bazë të nenit 4, pika 2 e Ligjit Nr. 04/L-088 për Arkivat Shtetërore, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës nxjerr këtë:

RREGULLORE

PËR HONORARËT E VEPRIMTARISË BOTUESE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË ARKIVAVE TË KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e pagesës së honorarëve të autorëve për botimet e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (në tekstin e mëtejmë Agjencia) dhe punët e tjera me honorar për veprimtarinë botuese të Agjencisë.

Neni 2

Për botimin e parë të librit/veprës/tekstit që boton Agjencia, honorari për autorin paguhet:

1. 12 € euro për faqe për libër/vepër/tekst origjinal, me tip të shkronjave Times New Roman, me madhësi të shkronjave 12 pikë, me numër të karaktereve 2700 për faqe, pa hapësirë mes rreshtave;
2. 6 € kur e gjithë faqja ka ilustrime (dokumente, faksimile, fotografji etj.) dhe nuk ka fjalë.

Neni 3

Përkthimi paguhet:

1. Për përkthimin nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe, 8 € për një faqe me numër të karaktereve 2700, pa hapësirë;
2. Për përkthim nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj, 10 € për një faqe me numër të karaktereve 2700, pa hapësirë;
3. Në raste të veçanta mund të aplikohen edhe tarifat e tregut në Kosovë, të institucioneve dhe të botuesve.

Neni 4

Redaktura e teksteve të përkthyera paguhet:

1. Për redakturën e të gjitha përkthimeve paguhet 30 % nga shuma e honorarit për përkthim;
2. Për tekstet që janë të vështira, si dhe për raste të tjera të veçanta, komisioni, në bazë të propozimit të redaksisë, mund të caktojë shumën më të lartë se honorari i caktuar deri në 50 %.

Neni 5

Për redakturë drejtshkrimore (lekturë), korrekturë, përgatitje teknike, radhitje kompjuterike, dizajn të kopertinës, për të angazhuarit, paguhet:

1. Për tekstet në gjuhën shqipe, 1.50 € për redakturë gjuhësore (lekturë) për një faqe me numër të karaktereve 2400, pa hapësirë mes rreshtave;
2. Për tekstet në gjuhë të huaj, 2.00 € për redakturë gjuhësore (lekturë) për një faqe me numër të karaktereve 2400, pa hapësirë mes rreshtave;
3. Për tekstet në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, 0.35 € për korrekturë për një faqe me numër të karaktereve 3000, me hapësirë mes rreshtave;
4. Për tekstet në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, 0.50 € për përgatitje teknike për një faqe me numër të karaktereve 3000, me hapësirë mes rreshtave;
5. Për tekstet në gjuhën shqipe, 2.50 € për radhitje kompjuterike për një faqe me numër të karaktereve 3000, pa hapësirë mes rreshtave;
6. Për tekstet në gjuhë të huaj, 3.00 € për radhitje kompjuterike për një faqe me numër të karaktereve 3000, pa hapësirë mes rreshtave;
7. Për dizajnimin e kopertinës të librit, të revistës a të një botimi tjetër të Agjencisë, 100.00 € për copë.

Neni 6

Për redaksinë e Revistës dhe për botimet shkencore të Agjencisë pagesa bëhet në formë paushalli:

1. Kryeredaktori - 200 € për secilin botim;
2. Sekretari i redaksisë - 120 € kur emri i tij është në librin/veprën a në revistën e botuar;
3. Anëtarët e redaksisë - 100 € paguhen vetëm për revistën „Arkivat shqiptare” dhe po kaq në rast të themelimit të ndonjë reviste të re nga Agjencia;
4. Recensemtët (vetëm të brendshëm) paguhen 100 € për çdo botim të librit nga Agjencia.

Neni 7

Botimi i librave nga Agjencia

1. Agjencia obligohet që me rastin e botimit të një libri, kur botimin e të njëjtit e financon vetë autorit, autorit të librit ia jep 50 % të numrit të ekzemplarëve;
2. I jepet honorar autorit (vetëm kur është punonjës i Agjencisë) për çdo botim të librit. (shuma e honorarit është e caktuar në Nenin 2 të kësaj Rregulloreje)
 2. 1. Nuk i jepet honorar autorit (punonjësit të Agjencisë që është bashkautor i dytë, i tretë e më tutje në një libër)
 2. 2. I jepet honorar autorit (vetëm punonjësit të Agjencisë) për librin e ribotuar me shkurtim 70 % nga honorari i përcaktuar në Nenin 2;

3. Me bashkëpunëtorin e jashtëm (studuesin - autorin), pas vlerësimit për botim të librit të tij nga recensemët, Agjencia paraprakisht lidh kontratë me të, me të cilën parashihet:
- 3.1. Agjencia formon një komision recensues, prej së paku dy anëtarësh të emëruar nga kryeshefi i Agjencisë për vlerësimin e librit, për të cilin recensemët janë vlerësim me shkrim;
 - 3.2. Agjencia, pos kryeredaktorit, vendos së paku një recensemët nga stafi i brendshëm i Agjencisë (me rastin e botimit të librit) nga fusha përkatëse;
 - 3.3. Përgatitjen teknike dhe shtypin e librit e merr përsipër Agjencia;
 - 3.4. Shtypi i librit bëhet sipas Kontratës së nënshkruara, por jo më pak se 200 ekzemplarë;
 - 3.5. Autorit të librit (studimit), pas shtypit të librit, i jepen 1/3 ekzemplarëve nga botuesi (Agjencia), kurse numrin tjeter të ekzemplarëve i ndal Agjencia për stafin e vet;
 - 3.6. Në rast se libri është përkthim në gjuhën shqipe, të drejtën e botimit duhet ta sigurojë dhe ta paguaj përkthyesi.

Neni 8

Për honorarët e shënuar më sipër, paguhet tatimi sipas shkallës së përcaktuar me ligj në Republikën e Kosovës.

I. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 9

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë.

Neni 10

Plotësim ndryshimet e kësaj Rregulloreje bëhen me procedurë të njëjtë me atë të aprovimit.

Neni 11

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet *Rregullorja për honorarët e veprimtarisë botuese të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Nr. 01/183/17, datë 19.05.2017.*

Datë:

19.1.2021

Kryeshefi Ekzekutiv i AShAK-së

BEDRI ZYBERAJ

